



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:167524  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05500151

KPPP.nr.1229/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTP “D-RRAHMANI”, me seli në Fushë Kosovë, me NUI: 810427692, kundër debitorit “KIMI” Sh.P.K., me NUI: 810727638, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.243/2022 të datës 23.06.2022, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 20.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “KIMI” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.243/2022 të datës 23.06.2022, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr.243/2022 të datës 23.06.2022, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturave dhe atë: Faturës nr.1086-19 të datës 21.08.2019, Faturës 1074-19 të datës 15.08.2019, dhe Faturës nr.1008-19 të datës 30.07.2019, duke urdhëruar debitorin që në emër të përmbartjes së obligimeve t’ia paguajë kreditorit shumën prej 240.00 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % duke llogaritur nga data e arritjes së borxhit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin, për faktin se i njëjti është lëshuar në bazë të faturave të cilat janë të paguara nga ana e debitorit, dhe atë fatura nr.1086-19 e datës 21.08.2019, dhe nr.1074-19 e datës 15.08.2019, ndërsa obligimi financiar i debitorit ndaj kreditorit është në vlerë prej 90.00 Euro. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit ndërsa të anulohet urdhri për përmbarimi i Përmbaresit Privat, dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore t'i paguajë kreditori.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit Faturën nr.1086-19 të datës 21.08.2019, Faturën nr.1074-19 të datës 15.08.2019, dhe Faturën nr.1008-19 të datës 30.07.2019, të cilat janë dorëzuar në kopje së bashku me propozimin. Megjithatë, debitori përmes prapësimit ka deklaruar se fatura me numër 1086-19 e datës 21.08.2019, dhe fatura me numër 1074-19 e datës 15.08.2019, janë të paguara nga ana e debitorit, ndërsa ndaj kreditorit ka borxh shumë prej 90.00 Euro.

Megjithatë, gjykata nga shkresat e lëndës vëren se debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pagesën e këtyre dy faturave, e për më tepër, debitori ka deklaruar në prapësim se ka obligim financiar ndaj kreditorit shumën prej 90.00 Euro (shuma e faturës nr.1008-19 e datës 30.07.2019), e që për gjykatën kjo nënkupton se debitori e ka pranuar borxhin që rrjedh nga të gjitha faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1229/23, me datë 20.03.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.